



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:276431
Datë: 19.12.2024
Numri i dokumentit: 06623515

ARJ nr.276/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar i kolegjit, Muhamet Rexha dhe Nenad Lazić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, H. I., nga P., rr. “Xh.K”, nr. ., kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës,(AKK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, parashtruar nga paditësi, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, AA nr. 853/2023, të datës 16.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 16 Dhjetor 2024, merr:

A K T V E N D I M

Hedhet e pas afatshme kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi, H.I., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, AA nr. 853/2023, të datës 16.09.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2027/2019, të datës 25.08.2023, refuzohet kërkesë padia e paditësit, H.I., me të cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në P, me numër nr. 03/1431/19, të dt. 20.08.2019, si e pa bazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, AA nr. 853/2023, të datës 16.09.2024, Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, H.I., nga P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2027/2019, i datës 25.08.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paditësi parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak

të; mos vërtetimit të gjendjes faktike nga organi i paditur dhe gjykata e instancave më të ulëta dhe faktit se ka mësuar për prova dhe rrethana të reja në bazë të cilave do të mund të merrej vendim përfundimtar më i favorshëm, të cilat gjenden në arshivën e Gjykatës Komunale në Nish, e cila i ka fizikisht dokumentet e Gjykatës Komunale të Prishtinës.

Gjykata Supreme pas vlerësimit të afatshmërisë së paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm të Vendimit gjyqësor, sipas nenit 24, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pas afatshme.

Me nenin 24 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet që kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrijë në Gjykatë Supreme, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrijë vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishin ndikim në zgjidhjen e çështjes.

Me nenin 50 të Ligjit për Konfliktet Administrative, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të vendimit kundër të cilit pala e paraqet kërkesën.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, AA nr. nr. 853/2023, të datës 16.09.2024, për mes Fletë Dërgesës për dorëzim personal në emër të R.F., avokat, sipas nënshkrimit të pranuesit, dhe datës së pranimit, konstatohet se është pranuar me datë, 09.10.2024, ndërsa kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paditësi e ka parashtruar, me datë 09.12.2024, (dëshmohet sipas vulës së pranimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë), për deri sa në kërkesë të paditësit, si datë e përpilimit të kërkesës shënohet data 25.11.2024.

Nga konstatimet si më lartë provohet se kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm nga paditësit është paraqitur pas afatit ligjor 30 ditë, ashtu si parashihet me nenin 50 të LKA, prandaj e njëjta hedhet si e pas afatshme.

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 52 paragraf 1, lidhur me nenin 24 dhe 50, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
ARJ nr.276/2024, me datë 16 Dhjetor 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani